



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Lagja "Minatori"

email: bashkiabulqize@hotmail.com

V E N D I M

NR 22 DATE 28 / 2 / 2018

"Miratimin e kërkeses së Bashkisë Bulqize, së bashku me dokumentacionin ligjor për akordimin e ndihmës financiare për rindertim të ures Valikardhe, Njesia Adm. Zerqan, Bashkia Bulqize, e cila është demtuar nga reshjete rena në periudhën Nentor-Dhjetor 2017 nga buxheti i Bashkisë dhe buxheti i vitit 2018 në Ministrinë e Pëneve të Brendshme, programi "Emergjencat Civile".

BAZA LIGJORE :

Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji Nr. 107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar, VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhenies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", "Keshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.02.2018 pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve Emergjencave Civile dhe Rrugeve Rurale, me 15 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim:

V E N D O S I :

1. Te miratojë kërkesën e Bashkisë Bulqize për mbështetje financiare për rindertim të ures së demtuar në Valikardhe, Njesia Adm. Zerqan, Bashkia Bulqize për demtimin e saj nga reshjet e rena.
2. Te miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Bulqize, dhe vlerën e dëmit të shkaktuar: 1.209.777 (njemilion dyqindë nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) leke dëme.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Pëneve të Brendshme për ndihmë financiare, për mbulimin e plotë të vlerës së dëmit për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar vlerën financiare të riparimit të dëmit të shkaktuar.
4. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ndertimin e ures në Valikardhe, Njesia Adm. Zerqan, Bashkia Bulqize

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

SEKRETARI
Agim TUCI

PER KESHILLIN BASHKIAK



KRYETARI
Gazmend KENGA